



# Cili është gjykimi abdesit, kur priset mes'hi?

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد. أما بعد

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me abdesin, kur priset mes'hi apo kur i mbaron koha.

Dijetarët janë ndarë në katër mendime siç thotë Imam Neueuijju (All-llahu e mëshiroftë).

## **Mendimi i parë**

Disa dijetarë thonë: *“Mjafton të lash vetëm këmbët dhe të falesh.”*

## **Mendimi i dytë**

Shumica e dijetarëve, prej tyre Shejkh Ibn Bazi, Abbadi, Feuzani, thonë:

*“Kur të mbaroje koha e mes'hit priset abdesi, duhet me marr abdes nëse do që të falet, sepse Profeti ka vendosur kohë për mes'hin, dhe kur i del koha është prish abdesi.”*

Shejkh Feuzani thotë: *“I priset abdesi, sepse ai, as nuk mund t'i jape mes'h ngase koha e tij mbaroi, dhe as nuk mund t'i laje këmbët.”*

## **Mendimi i tretë**

Disa dijetarë tjerë thonë:

*“Nëse i priset mes'hi apo i mbaron koha mes'hit, nëse merr abdes menjëherë, kjo i mjafton, mund të falet. E nëse e vonon larjen e këmbëve, atëherë duhet me marr abdes nga fillimi pastaj të falet.”*

## **Mendimi i katërt (Më i sakti)**

Ndërsa disa dijetarë tjerë thonë: *“Prishja e mes'hit nuk e prish abdesin.”*

Dmth: nëse robi ka abdes dhe i priset mes'hi, abdes ka. Sepse nuk ka argument që tregon se prishja e mes'hit e prish abdesin.

Shejkh Ibn Uthejmini thotë:

*“Nuk ka argument për këtë nga Kur'ani, dhe as nga Sunneti i të Dërguarit të Tij sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe as nga ixhmaja (Unanimiteti) i dijetarëve. Profeti alejhis-salam e ka vendosur kohën e mes'hit për të treguar fundin e kohës së tij, dhe jo mbarimin (prishjen) e abdesit.”*

Ky është mendimi i Ibn Hazmit, i Ibn Tejmijes, Shejkh Albanit, Ibn Uthejminit, Ferkusit.

Është saktësuar (siç thotë shejkh Albani) nga Aliu Radijall-llahu anhu, i cili iu ka dhënë mes'h sandaleve, dhe pastaj i hoqi dhe u fal.

### **Kur vesh çorape tjera sipër çorapeve të para, ose këpucë.**

Shejkh Ibn Uttejmini thotë:

*“Nëse ke mes'h, dhe vesh çorape tjera sipër çorapeve të poshtme të cilave iu ke dhënë mes'h, apo vesh këpucët, atëherë:*

*-Nëse nuk ke abdes (dmth: e vesh palën e dytë të çorapeve duke mos patur abdes), në këtë rast i jep mes'h çorapeve të poshtme.*

*-E nëse e vesh palën e dytë të çorapeve ose këpucët duke patur abdes, në këtë rast i jep mes'h çorapeve të sipërme, dhe këpucëve.”*

Shejkhu përmend se ky është mendimi i imam Neueuiut.

[Fetewa Et-Tahaara 192 / Islamqa.info]

Të njejtin mendim ka dhe Bin Bazi.

وقال ابن باز: إذا لبس الخف الفوقاني بعد الطهارة جاز المسح عليه ولو كان مسح على التحتاني قبل ذلك.

Shumica e dijetarëve nuk e lejojnë këtë.

Ibn Kudame thotë: “Në këtë rast mundet të fut dorën poshtë çorapeve të sipërme që t’iu jape mes’h çorapeve të poshtme. Ama të sipërmeve nuk iu jep mes'h, edhe nëse i vesh me abdes.

Shejkh Feuzani All-llahu e ruajt thotë: “U jep mes'h të poshtmeve, jo të sipërmeve. Përveç nëse i ke veshur çorapet e sipërme përpara se t’i japësh mes'h të poshtmeve.”

### **Nëse vesh dy palë çorape, apo këpucë, dhe iu jep mes'h çorapeve të sipërme, ose këpucëve.**

Kur t’i heqësh çorapet e sipërme, ose këpucët, a bën t’u jepet mes'h çorapeve të poshtme?

Në lidhje me këtë nuk kam gjetur ndonjë fjalë dijetari, përpos fjalës se Ibn Uttejminin i cili thotë:

*“Po. Iu jep mes'h çorapeve të poshtme.”*

All-llahu e di më së miri

Ai është më i Dijshmi

-----

و الحمد لله رب العالمين

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله و صحبه و سلم